

Nr. .... Prot  
*Lutemi referoni këtë numër në përgjigje*

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_. 2022

## **Lënda : Në përgjigje të kërkesës tuaj**

Në përgjigje të kërkesës tuaj në portalin Pyet Shtetin datë 19.09.2022 dhe e regjistruar me nr.834 ju informojmë si më poshtë :

### *Pyetja 1*

**Një pasqyre të planit të financimit të projektit HEC Skavice, Faza 1 dhe Faza 2, me buxhetin dhe burimin e financimit.**

Faza e parë e projektit Skavica është kontraktuar sipas kontratës së miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 485, date 30.07.2021.

Faza e dytë sipas Ligjit Nr. 38/2021 është faza e ndërtimit.

Aktualisht faza e parë nuk ka përfunduar dhe te dhënat financiare për fazën e dytë që rrjedhin nga projekti paraprak i HEC Skavica, nuk janë përmbyllur. Kujtojmë që aktualisht po vijon vlerësimi i të dhënave teknike nga ana e Kontraktorit.

### *Pyetja 2*

**-Eshte banka DFC qe ka pranuar te financoje kete projekt?**

Për sqarim. Me DFC kuptojmë (U.S. International Development Finance Corporation).

Aktualisht nuk kemi dijeni nëse DFC është e interesuar për financimin e projektit Skavica. Vete veprimtaria e DFC (U.S. International Development Finance Corporation) ushtron veprimtari për financimin e aktiviteteve private, jo të entiteteve tregtare me kapital të zotëruar nga Shteti.

### *Pyetja 3*

#### **- Cili është vendi i propozuar për zhvendosjen e banorëve të prekur nga HEC Skavicë?**

Aktualisht studimi i fazës së parë është akoma në proces. Propozimet për vendin e zhvendosjes do të jenë të sakta pas realizimit të kontakteve në vend me banorët e zonës, gjatë fazës së njoftimit të rezultateve të fazës së parë të projektit.

### *Pyetja 4*

#### **- Cila është kuota e miratuar për tu propozuar për ndërtimin e digës në fazën e dytë të HEC Skavicë?**

Aktualisht nuk ka një kuotë të miratuar të projektit. Brenda muajt tetor do të jemi të njohur me të dhënat lidhur me kuotat e propozuara, të projektit sipas studimeve të bëra..

### *Pyetja 5*

#### **Sa është sipërfaqja e propozuar për tu prekur nga HEC Skavica, faza 2, e ndarë në tokë e punëshme dhe kategori të tjera të tokës, duke përfshirë dhe toke pyjore, e ndarë në kategori pyjesh.**

Të dhënat përfundimtare për kërkesën e berë do të rezultojnë në materialin përfundimtar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe pasi të jetë miratuar kuota përfundimtare e projektit.

### *Pyetja 6*

#### **Sa është nr i banesave dhe i banorëve që preken nga HEC Skavica, faze e 2-të?**

Te dhënat përfundimtare për kërkesën e berë do të rezultojnë në materialin përfundimtar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe pasi të jetë miratuar kuota përfundimtare e projektit.

### *Pyetja 7*

#### **Cili është rezultati i propozuar për ndikimin në mjedis gjetur gjatë fazës së parë të HEC Skavica?**

Dokumenti i Vlerësimit të ndikimit në mjedis është akoma në përpunim dhe nuk ka përfunduar.

### *Pyetja 8*

#### **Cili është rezultati i propozuar për ndikimin social gjatë fazës së parë të HEC Skavicë ?**

Dokumenti i Vlerësimit të ndikimit social është akoma në përpunim dhe nuk ka përfunduar.

## *Pyetja 9*

### **A është HEC Skavica në përputhje me kërkesat e progres raportit të BE për vitin 2021 sa i përket fushës së energjisë ?**

Projekti ka marrë në konsideratë kërkesat e progres raportit sa i përket fushës së energjisë.

Gjate fazës se parë ëe studimit të projektit Skavica është vlerësuar ndër qëllimet e tjera të HEC Sakavicës edhe ai menaxhimit e riskut hidrologjik te Shqipërisë. Projekti merr në konsiderate si një nder elementet thelbësor të tij, menaxhimin e riskut hidrologjik te kaskadës së Drinit, duke i dhënë mundësi kaskadës në trajtimin e prurjeve hidrike me kapacitete rezervuese, bazuar edhe projektimin fillestar të vete kaskadës së Drinit, i cili është i pa përmbyllur. Gjithashtu kapacitetet rezervuese hidrike janë instrument i trajtimit të mangësive teknologjike të gjenerimit nga burimet e tjera të rinovueshme si energjia nga diell. Këto kapacitete rezervuese rrisin mundësinë teknike për implementimin e projekteve të reja për gjenerimin e energjisë nga burime alternative.

**Faleminderit!**